



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
DEPARTAMENTI OPERACIONAL

Nr. 90 prot.

Tiranë, më 12.01.2021

U R D H Ë R

Nr. 10, datë 12.01.2021

PËR NJËSIMIN E DOKUMENTIT ADMINISTRATIV

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 11, pika b, të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në Autoritetet Publike të Republikës së Shqipërisë”;

U R D H Ë R O J:

1. Dokumentet administrative, të përpiluara sipas normave Tekniko-Profesionale të Republikës së Shqipërisë duhet të jenë në përputhje me modelet bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Siglimi i kopjes së dytë të dokumenteve kryhet si më poshtë:  
*Konceptoi:* Nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i konceptuesit.  
*Pranoi:* Nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i përgjegjësit të strukturës së nivelit të pare, (nëse ka).  
*Miratoi:* Nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i përgjegjësit të strukturës së nivelit të dytë, (nëse ka).  
*Konfirmoi:* Nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i përgjegjësit të strukturës së nivelit më lart (nëse ka), apo pozicionit tjetër të përcaktuar në rregulloren e brendshme të funksionimit të institucionit.
3. Dokumentet të përpilohen me shkrim Times New Roman, me madhësi 12 dhe hapësira midis rreshtave të jetë 1.15, si dhe në anësore të lihen 3 cm bosh, ndërsa në krye e në fund të faqes nga 2 cm.

4. Dokumentet të përpilohen në bazë të rregullave drejtshkrimore, ku të përdoren gërmat (ë) dhe (ç), si dhe kryeradhët.
5. Struktura të shënohet në dokumentet administrative, vetëm në nivelin e strukturës më të lartë (Departamentit, Drejtorisë, ose Sektorit, etj. sipas rastit) që ka konceptuar dokumentin. Titullari i institucionit është strukturë më vete. Në rastin e dokumenteve të konceptuara nga ai, emërtesa e titullarit shënohet si strukturë më vete sipas organikës.
6. Përjashtimisht, në rastet kur dokumentet janë produkt i pozicioneve të posaçme të punës, të parashikuara në ligj dhe që nuk janë strukturë më vete, pozicionet shënohen poshtë strukturës përkatëse, ku ndodhet pozicioni i posaçëm, sipas rastit, Struktura Përgjegjëse për Sinjalizuesit, Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Koordinatori për të Drejtën e Informimit, Njësia e Burimeve Njerëzore e të tjera.
7. Njësia e Prokurimeve, Grupi i Menaxhimit Strategjik, grupet ad-hoc të punës, Komisioni i Ekspertizës, si dhe të gjitha njësitë e tjera të ngritura sipas ligjit specifik në nivelin më të lartë drejtues, shënohen si nënstrukturë, poshtë strukturës me emërtesën e titullarit.
8. Sekretari-Arkivi i institucionit njofton titullarin në të gjitha rastet kur shkresat nuk përpilohen sipas këtij urdhri.
9. Ngarkohen strukturat e Autoritetit, pozicionet e posaçme të punës, sipas ligjit, dhe Sekretari-Arkivi për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin Mete**



Model 1 (për dokumentet që dalin nga institucioni)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**(EMËRTIMI I INSTITUCIONIT FONDKRIJUES)**  
**(EMËRTESE E INSTITUCIONIT TË VARËSISË - NËSE KA)**  
**(EMËRTESE E STRUKTURËS)**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.201\_

Lënda: (Shënohet shkurtimi përmbajtësor i dokumentit).

**(EMËRTIMI I PLOTË NË RASËN DHANORE, ME GËRMA KAPITALE, I**  
**INSTITUCIONIT TË CILIT I DËRGOHET)**  
**(Emërtimi i vendit ku ka selinë institucioni të cilit i dërgohet)**

Për dijeni: (në rastet kur janë institucione të tjera për dijeni shënohet emërtesa dhe vendi ku ka selinë institucioni, njësoj si më sipër)

Në vijim / Në përgjigje suajës / tonës me Nr.\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.\_\_\_\_  
.....  
.....

**(EMËRTIMI, ME GËRMA KAPITALE,**  
**I FUNKSIONIT TË TITULLARIT)**

**(Emri e Mbiemri)**

Adresa e plotë e institucionit, numri i telefonit, faqja zyrtare në internet (nëse ka), adresa e postës elektronike

Model 2 (për dokumentet që dalin nga institucioni në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**(EMËRTIMI I INSTITUCIONIT FONDKRIJUES)  
(EMËRTESE E INSTITUCIONIT TË VARËSISË - NËSE KA)  
(EMËRTESE E STRUKTURËS)**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 201\_

Lënda: (Shënohet shkurtimi përmbajtësor i dokumentit).

**(EMËRTIMI I PLOTË NË RASËN DHANORE, ME GËRMA KAPITALE, I  
INSTITUCIONIT TË CILIT I DËRGOHET)  
(Emërtimi i vendit ku ka selinë institucioni të cilit i dërgohet)**

**Për dijeni:** (në rastet kur janë institucione të tjera për dijeni shënohet emërtesa dhe vendi ku ka selinë institucioni, njësoj si më sipër)

Në vijim / Në përgjigje suajës / tonës me Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_,  
.....  
.....

**(EMËRTIMI, ME GËRMA KAPITALE,  
I FUNKSIONIT TË TITULLARIT)**

(Emri e Mbiemri)

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
(EMËRTIMI, ME GËRMA KAPITALE,  
I FUNKSIONIT TË TË AUTORIZUARIT)**

(Emri e Mbiemri)

Adresa e plotë e institucionit, numri i telefonit, faqja zyrtare në internet (nëse ka), adresa e postës elektronike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

(EMËRTIMI I INSTITUCIONIT FONDKRIJUES)  
(EMËRTESA E INSTITUCIONIT TË VARËSISË - NËSE KA)  
(EMËRTESA E STRUKTURËS)

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 201\_

(Emërtimi, me gërma kapitale, i llojit të dokumentit:  
URDHËR / VENDIM / UDHËZIM etj.)

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 20 \_\_\_\_

PËR  
(TITULLIN E URDHËRIT / VENDIMIT / UDHËZIMIT ETJ ME GËRMA  
KAPITALE, QENDËR, E THEKSUAR)

(Baza ligjore).....  
.....

(URDHËROJ: / VENDOSA: / UDHËZOJ: /etj., sipas rastit)

1. (teksti i vendimit, sipas elementeve të përcaktuara në Kodin e Procedurave  
Administrative).....  
.....

(EMËRTIMI, ME GËRMA KAPITALE,  
I FUNKSIONIT TË TITULLARIT)

(Emri e Mbiemri)

(Shënim: Në rastet kur Kodi i Procedurave Administrative parashikon që akti duhet të jetë i arsyetuar, shtohet pjesa e arsyetimit, duke shënuar të qëndërsuar "KONSTATOVA SE:" e pasuar nga teksti arsyetues, përpara pjesës normative.)

Adresa e plotë e institucionit, numri i telefonit, faqja zyrtare në internet (nëse ka), adresa e postës elektronike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

(EMËRTIMI, ME GËRMA KAPITALE,  
I INSTITUCIONIT PALË)

(EMËRTEZA E INSTITUCIONIT TË  
VARËSISË - NËSE KA)

(EMËRTEZA E STRUKTURËS)

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

(Qyteti ku ka selinë), më \_\_\_\_.

(EMËRTIMI, ME GËRMA KAPITALE,  
I INSTITUCIONIT PALË)

(EMËRTEZA E INSTITUCIONIT TË  
VARËSISË - NËSE KA)

(EMËRTEZA E STRUKTURËS)

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

(Qyteti ku ka selinë), më \_\_\_\_.

**MARRËVESHJE**

**PËR**

**(TITULLIN E MARRËVESHJES ME GËRMA KAPITALE, QENDËR E  
THEKSUAR)**

.....  
.....  
.....  
.....  
.....  
.....  
.....

**PËR**

**(EMËRTIMI NË RASËN KALLZORE,  
ME GËRMA KAPITALE, I  
INSTITUCIONIT PALË NË  
MARRËVESHJE)**

**PËR**

**(EMËRTIMI NË RASËN KALLZORE,  
ME GËRMA KAPITALE, I  
INSTITUCIONIT PALË NË  
MARRËVESHJE)**

**(EMËRTIMI, ME GËRMA KAPITALE,  
I FUNKSIONIT TË NËNSHKRUESIT)**

**(EMËRTIMI, ME GËRMA KAPITALE,  
I FUNKSIONIT TË NËNSHKRUESIT)**

(Emri e Mbiemri)

(Emri e Mbiemri)